



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Me 07.03.2024

M a m u s h ë

Referenca : 626-24-001-2-2-1

Në bazë të Nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, RREGULLORES 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 43 Paragrafi 43.5 pika (b) si udhëheqës i sektorit të Prokurimit bie këtë:

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-24-371-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-001-2-2-1

II

Tenderi do të rishpallet pas afatit ligjor për parashtrimin e ankesave eventuale.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 24.01.2024 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: SIGURIMI TPL DHE TPL+ I AUTOMJETEVE TE KOMUNES SE MAMUSHES me nr. të prokurimit 626-24-371-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-001-2-2-1. Pas njoftimit për kontratë, dosjen e tenderit e kanë shkarkuar Shtatë(7) Operator Ekonomik , ndërsa tenderin e kanë dorëzuar vetëm tre (3) prej tyre, ku duke u bazuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, asnjëri prej tyre nuk ka qenë i përgjegjshëm.

Në bazë të legjislacionit të prokurimit në rastet kur pas hapjes së tenderit vërtetohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme, kërkohet që të anulohet procedura e prokurimit në fjalë.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) të RREGULLORES 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi

Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

